




UDHËZUES PËR NJOFTIMIN E MENJËHERSHËM NË ONLINE BANKING (PUSH NOTIFICATION)

1. Çfarë janë Push Notifications?

Push Notifications janë njoftime automatike që dërgohen në pajisjen tuaj mobile përmes aplikacionit të bankës, me qëllim informimin në kohë reale për veprimet dhe transaksionet që lidhen me llogarinë, kartën tuaj bankare ose njoftime të tjera të përgjithshme. Këto njoftime shfaqen direkt në ekranin e telefonit tuaj, edhe kur aplikacioni i bankës nuk është i hapur.

PUSH Notification: Njoftim i menjëhershëm që vjen në telefon përmes aplikacionit të bankës

2. Kur merrni Push Notifications?

Ju do të merrni push notifications për veprime të ndryshme si:

- Kur llogaria juaj debitohej ose kreditohet (p.sh. pagesa, transfertë, depozitime, tërheqje fondesh etj)
- Kur kryeni veprime me kartë bankare (p.sh. pagesa në dyqan, pagesa online, tërheqje nga bankomati)
- Njoftime të përgjithshme (p.sh. kujtesë për pagesën këstit të kredisë, kartës së kreditit, etj.)
- Për konfirmim të transaksioneve të kryera me kartë

3. Përfitimet e Push Notifications

Përdorimi i push notifications ju mundëson:

- Informim të menjëhershëm për çdo veprim financiar në llogarinë tuaj
- Monitorim të vazhdueshëm të llogarisë dhe kartës
- Rritje të nivelit të sigurisë
- Reagim të shpejtë në rast të veprimeve të paautorizuara

4. Si të Aktivizoni Push Notifications?



Për të marrë push notifications, duhet të:

- Keni të instaluar aplikacionin e bankës në pajisjen tuaj mobile
- Lejoni marrjen e njoftimeve (notifications) në cilësimet e telefonit tuaj
- Keni lidhje aktive interneti

Shënim i Rëndësishëm: Push notifications kanë karakter informues dhe nuk zëvendësojnë dokumentacionin zyrtar bankar, si levizjet e llogarisë ose konfirmimet formale të transaksioneve


Prezantim ilustrativ se si shfaqen push notifications:

Hapi 1: Në pajisjen tuaj mobile vjen push notification dhe shfaqet në pjesen sipër të telefonit i cili përmban vetëm subjektin e njoftimit.



UDHËZUES PËR NJOFTIMIN E MENJËHERSHËM NË ONLINE BANKING (PUSH NOTIFICATION)

Hapi 2: Për të lexuar përmbajtjen e njoftimit klikohet mbi push notification dhe ridrejtoheni në faqen kryesore të aplikacionit të bankës për tu identifikuar në aplikacion. Pasi të jeni identifikuar aplikacioni ju ridrejton tek përmbajtja e njoftimit.



Shënim. Mesazhin e dërguar me anë të push notification keni mundësi ta fshini ose ta mbani tek lista e mesazheve.

Hapi 3: Njoftimet push notification mund të aksesohen dhe lexohen edhe në rast se nuk klikohet ikona e push notification që ka ardhur në pajisjen tuaj mobile. Ju mund ta bëni direkt nëpërmjet aplikacionit të bankës. Pasi klikohet tek menuja “Kujdesi ndaj Klientit”, ridrejtoheni tek menuja “Njoftime” ku do të gjeni meazhin e dërguar.

